



**Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDRY SHE**

*15 qershor 2013, Prizren*

**KOMUNIKATË PËR MEDIA**

**Investimet e komunës në shtëpinë e Shuaip Pashës pa planifikim të definuar**

Në kuadër të projektit të monitorimit të punës së ekzekutivit komunal të Prizrenit, EC Ma Ndryshe gjatë muajve të kaluar ka shqyrtuar çështjen e rindërtimit të shtëpisë së Shuaip Spahiut nga mjetet e buxhetit komunal.

Hulumtimi i “EC Ma Ndryshe” ka nxjerrë në pah faktin se qeveria komunale respektivisht Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor ka nisur realizimin e projektit pa i sqaruar në tërësi kontestet pronësore me pronarët legjitim të këtij objekti, ndërkohë që nuk ka pas plan të qartë as për destinimin përfundimtar të kësaj shtëpie, që dikur ka përfaqësuar vlera të rralla të arkitekturës urbane të Prizrenit.

Përmes kërkesës për qasje në dokumente publike EC Ma Ndryshe nga DUPH-ja ka kërkuar dosjen për realizimin e projektit të rindërtimit të shtëpisë së Shuaip Spahiut, sikurse edhe informatat mbi vlerën e investimeve, lidhjen e kontratës mes komunës dhe pronarëve dhe destinimin përfundimtar të objektit.

Në përgjigjen e dhënë nga DUPH-ja thuhet se “objekti në fjalë ende nuk është përfunduar me procedura të tjera nga arsyet se ka probleme pronësore juridike me pronarët e këtij objekti (dise pronarë), ku ende në mes të pronarëve nuk është arritur ndonjë marrëveshje për kompensim”. DUPH nuk ka dhënë përgjigje të qartë mbi destinimin e objektit pas investimit të mjeteve nga buxheti komunal. “Po ashtu, faza e dytë e punimeve vazhdohet, pasi që të mbyllet kontrata në fazën e parë dhe destinimi i objektit caktohet pasi që të kryhen veprimet e palëve të cekura si më lartë”. Ndërsa çmimi i tërësishëm për përmbushjen e kontratës “Rikonstruimi i shtëpisë së Shuaip Pashës Spahiut në Prizren” i lidhur me operatorin ekonomik përkatës është 112 mijë e 920 euro.

EC Ma Ndryshe nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka siguruar edhe kartelën analitike të pagesave për rindërtimin e kësaj shtëpie, në të cilën figuron se komuna ka paguar 107 mijë e 773 euro për realizimin e fazës së parë të punimeve.

Përderisa faza e dytë e projektit kishte mbetur pezull në organet komunale të Prizrenit vjen kërkesa nga Akademia Diplomatike e Kosovës që ky objekt t’i jepet në shfrytëzim këtij institucioni. Gjatë debatit në KPF të KK-së është thënë se komuna e Prizrenit ka investuar mjete nga fondet publike në një projekt pa destinim të qartë. Gjendjen aktuale të objektit, kryesuesi i KK-së e ka vlerësuar “për gjynah”.

Këshilltarët e KK-së në mbledhjen e datës 23 maj 2013, kanë marrë dy vendime në lidhje me këtë çështje. Vendimin për shpalljen e interesit të përgjithshëm, me të cilin parashihet shpronësimi dhe kompensimi i pronarëve dhe vendimin për dhënien në shfrytëzim për nevojat e Akademisë Diplomatike të Kosovës.

EC Ma Ndryshe konsideron se kjo mënyrë e planifikimit dhe realizimit të projektit nuk përputhet me standardet e qeverisjes së mirë. Investimi i mbi 100 mijë eurove të taksapaguesve prizrenas në një projekt ku ka konteste pronësore dhe pa pasur një plan të qartë për destinimin përfundimtar të tij dëshmon papërgjegjësinë e pushtetit lokal ndaj parimit për menaxhimin e mirë të parasë publike.

EC Ma Ndryshe vlerëson se para fillimit të rindërtimit të objektit, komuna e Prizrenit është dashur që të arrij një marrëveshje me pronarët dhe të ketë një plan të qartë për destinimin e këtij objekti.

EC Ma Ndryshe rekomandon komunën e Prizrenit që paratë publike mos t'i investoj në projektet që kanë konteste pronësore dhe pa një elaborim të thuktë për funksionalitetin dhe dobinë për qytetarët e Prizrenit.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, [www.online-transparency.org](http://www.online-transparency.org).

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Saraqët, Nr. 5 - Prizren  
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy  
Prishtina

*Projekti "Transparenca online e komunës së Prizrenit" prej muajit shtator 2012 përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*